BASHKIA MA...
Z... Protok...
Nr. 593 ...Pro...
Date...06.2.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË

Korçë, më 30.01.2026

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar :Bashkia Maliq

Për shtetasen Elena Florentina Sandu me adrese : Blloku Rinia nd. 27 H,. 10 Ap. 11 Maliq

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shpalljen për vendimin civil nr. 982 dt. 15.12.2025 te Gjykates se Shkalles se Pare te uridikisonit te Pergjithshem Korce, për t'u afishuar nga ana Juaj njoftimi me shpallje me afat *20 ditor,* pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin " larguar ..." dhe pas afishimit kjo shpallje të na kthehet e konfirmuar me vulë e firmë, në gjykatë.

KANCELARE
Geralda Kasuli

U afishua sot në datë ----------
Per : Bashkine Maliq

(emër, mbiemër, firmë)

33

- ST IMP
dt 06.02.2026

Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

KORÇË

Nr.Regj.Themeltar 21001-01361-41-2024-948 (1978) **Nr.Vendimi 41-2025-4308(982)**

Dt.Regj. 14.10.2024 **Data e vendimit 15.12.2025**

V E N D I M

"PËR PUSHIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përbërë nga:

GJYQTARE: ELARINDA XHINDI

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Vitoria Hajçe**, sot më datë 15.12.2025, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile me Nr.Regj.Themeltar **21001-01361-41-2024-948 (1978)** dhe datë regjistrimi **14.10.2024,** që i përket palëve:

PADITËS: **Taulant Sandu**, i biri i Beqir dhe Donika, i datëlindjes18.10.1995, lindur në Korçë dhe banues në Maliq 7005, Blloku "Rinia", Nd.27, H.10, Ap.11, me gjendje civile "i martuar", me shtetësi shqiptare, me Nr.Personal J51018120l, përfaqësuar nga A.Nevzat Tarelli dhe Av. Xhorxhia Anxhara sipas prokurës së posaçme me nr.3892 Rep., nr.2636 Kol., datë 25.11.2024 ***(Njoftimet të kryhen tek Av. Nevzat Tarelli në Korçë, nr.Cel: 0692085511)***.

E PADITUR: **Elena-Florentina Sandu**, me atësi të panjohur, e bija e Florentina, e datëlindjes 12.11.1997, lindur në Botoshani, Rumani dhe banuese në Maliq 7005, Blloku "Rinia", Nd.27, H.10, Ap.11, me gjendje civile "e martuar", shtetësi Rumune.(*në mungesë).*

OBJEKTI: Kërkohet zgjidhja e martesës midis paditësit dhe të paditurës, përcaktimi i pasojave të zgjidhjes së martesës.

BAZA LIGJORE: Nenet 129, 132 e vijues të Kodit të Familjes.

Scanned with CamScanner

Gjykata pasi çeli seancën e planifikuar për tu zhvilluar ditën e sotme, datë 15.12.2025, ora 12:00, në bazë të nenit 175 të Kodit të Procedurës Civile, verifikoi paraqitjen e palëve. Nuk u paraqit personalisht pala paditëse Taulant Sandu por ishte prezente përfaqësuesja sipas prokurës së posaçme Av.Xhorxhia Anxhara. Gjithashtu nuk u paraqit as pala e paditur Elena-Florentina Sandu për të cilën gjykata kishte proceduar me kryerjen e njoftimit në adresën që rezulton nga aktet e gjendjes civile dhe letërthirrja është kthyer me shënimin *"larguar"*.

Nga ana e përfaqësueses së palës paditëse iu bë me dije Gjykatës se palët ndërgjyqëse janë pajtuar dhe kërkojnë pushimin e gjykimit.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e berë në seancë nga përfaqësuesja e palës paditëse për heqjen dorë nga gjykimi dhe pushimin e tij,

V Ë R E N S E:

1. Paditesi Taulant Sandu ka paraqitur në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, kërkesëpadinë me objekt zgjidhjen e martesës midis paditësit dhe të paditurës dhe përcaktimin e pasojave të zgjidhjes së martesës, në bazë të neneve 129, 132 e vijues të Kodit të Familjes.

2. Kjo kërkesë-padi është regjistruar në datë 14.10.2024. Nëpërmjet shortit elektronik i është caktuar fillimisht për gjykim gjyqtares Dorinela Nikolli. Në kushtet kur kjo gjyqtare nuk ushtron më funksionin pranë kësaj gjykate, për shkak të komandimit si Ndihmës-Magjistrate në Gjykatën e Lartë, bazuar në urdhërin e brendshëm të titullares së Gjykatës, të gjitha çështjet e saj përfshirë edhe çështja objekt gjykimi janë rihedhur në short elektronik. Me shortin elektronik të datës 27.10.2025 i ka kaluar për gjykim kësaj trupe gjykuese.

3. Bazuar në nenin 36/1 të K.Pr.Civile, gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi hyn në juridiksionin gjyqësor dhe se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje, referuar neneve 41 dhe 349 gërma "a" të K.Pr.Civile. Po ashtu kjo gjykatë ka kompetencën tokësore referuar nenit 51 të K.Pr.Civile, pasi është gjykata e vendit ku bashkëshortët kanë pasur banimin e tyre të përbashkët të fundit.

4. Nga verifikimi i veprimeve paraprake të kryera nga gjyqtarja e mëparshme, rezultoi se faza në të cilën ndodhej gjykimi ishte në seancën e pajtimit, e cila nuk ishte realizuar ende për shkak të mos marrjes dijeni të palës së paditur. Për këtë arsye nga ana e gjykatës u vendos caktimi i datës 15.12.2025, ora 12:00, si datë për zhvillimin e seancës së pajtimit dhe u njoftuan palët për paraqitje. Për palën paditëse njoftimi u krye tek Av.Nevzat Tarelli, ashtu siç ishte kërkuar prej tij, ndërsa letërthirrja për të paditurën u kthye me shënimin *"larguar"*, nga vendbanimi i saj zyrtar që rezultonte nga aktet e gjendjes civile.

Scanned with CamScanner

5. Në fillim të seancës siç u parashtrua dhe në pjesën hyrëse të këtij vendimi, përfaqësuesja e palës paditëse, Av.Xhorxhia Anxhara deklaroi se mes palëve ishte arritur pajtimi jashtëgjyqësisht dhe për këtë arsye kërkoi që të heq dorë nga gjykimi dhe të vendoset pushimi i gjykimit, duke qenë se ky është edhe vullneti i palëve.

6. Në kushtet ku pala paditëse nuk u paraqit personalisht që të mund të konfirmonte faktin e pajtimit me bashkëshorten e tij, por vullneti për heqjen dorë u shpreh përmes paraqitjes në seancë të përfaqësueses me prokurë të posaçme, Gjykata verifikoi tagrat e dhëna prej tij avokates. Konkretisht në prokurën e posaçme me nr.3892 Rep., nr.2636 Kol., datë 25.11.2024, ndër të tjera i përfaqësuari u ka dhënë të drejtë Avokatëve që së bashku ose veç e veç, të kryejnë porositë e mëposhtme: *"të ngrerë padi me objekt zgjidhje martese...të marrë pjesë në seancë pajtimore...Përfundimisht, çdo veprim që do të kryej përfaqësuesi im, e njoh si të drejtë mjafton të ketë lidhje me çështjen e mësipërme"*.

7. Bazuar në sa më sipër Gjykata, vlerëson se kërkesa e palës paditëse për heqjen dorë nga gjykimi, e shprehur në seancë nëpërmjet përfaqësueses së tij dhe pushimin e gjykimit, për shkak të arritjes së pajtimit mes tyre, duhet pranuar. Ndodhemi në kushtet e nenit 201 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet se: *"1.Paditësi në cdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të padituri nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes. 2.Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të padituri nuk ka shkak të ligjshëm"*.

8. Gjithashtu në bazë të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: "Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: *"paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë*". Ndërsa në bazë të nenit 300 të po këtij Kodi, pushimi i gjykimit nuk e shuan padinë.

9. Në këto rrethana, gjykata referuar kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, çmon se në këtë rast duhet të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes për këtë shkak, bazuar në nenin 299/b të K.Pr.Penale. Shpenzimet gjyqësore të këtij gjykimi përbëhen nga taksa mbi aktet në masën 3.000 lekë dhe shpenzimet për njoftimet në shumën 260 lekë, të parapaguara nga paditësi. Në vështrim të nenit 106 e vijues të K.Pr.Civile, në kushtet e pushimit të gjykimit, këto shpenzime mbeten në ngarkim të paditësit sikurse janë bërë.

10. Përsa i përket të drejtës së ankimit, kundër vendimit me të cilin vendoset pushimi i gjykimit, mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 127, 201, 299/b, 300 dhe 301 të Kodit të Procedurës Civile dhe 135 të Kodit të Familjes,

Scanned with CamScanner

VENDOSI:

1. Pushimin e gjykimit të çështjes civile nr.regj.Themeltar **21001-01361-41-2024-948/1978, me datë regjistrimi 14.10.2024**.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall sot, në Korçë, më datë 15.12.2025.

SEKRETARE
VITORIA HAJÇE

GJYQTARE
ELARINDA XHINDI

RR 808 687 692 AA

Scanned with CamScanner